



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 19

G U S H T 2 0 2 4

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë dhe Pritjet për Inflacionin

(TM1 2024 dhe pritjet për TM2 2024)

Numër 19

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK) -----	4
Hyrje -----	4
Përmbledhja e rezultateve -----	4
Kutia 1. Metodologjia -----	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi -----	7
Kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	8
Standardet kreditore -----	8
Kushtet dhe rregullat-----	8
Kërkesa për kredi-----	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Standardet kreditore -----	10
Kushtet dhe rregullat-----	11
Kërkesa për kredi-----	12
Financimi -----	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara -----	14
Pritjet për Inflacionin -----	14
Metodologjia -----	15
Përmbledhja e rezultateve -----	15

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2024, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e dytë të vitit 2024.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zberthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Stoku i kredive vazhdoi të karakterizohet me rritje edhe në tremujorin e parë të vitit 2024, megjithëse me ritëm më të ngadalshëm kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Kreditë e reja shënuan rritje më të lartë vjetore, por më të ngadalësuar tremujore në TM1 2024. Dinamikën në aktivitetin kreditor u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime margjinale në të dy kahjet (negative/pozitive) gjatë këtij tremujori. Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin që shtytësi i aktivitetit kreditor të vazhdoj të jetë kërkesa kreditore në rritje, ndërkohë që edhe oferta kreditore pritet të ketë ndryshime margjinale në rrafshin pozitiv.

Sa i përket segmentit të ndërmarrjeve, bankat raportuan se dinamika e kreditimit ndaj tyre u përcaktua kryesisht nga kërkesa kreditore, që shënoi rritje deri në një masë, përderisa oferta kreditore për këtë segment kishte ndryshime margjinale negative (shtrëngim të lehtë). Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan se do të aplikojnë standarde kreditore të shtrënguara deri në një masë, si për ndërmarrjet e mëdha ashtu dhe për NVM-të (tabela 1). Cilësia e portfolios kreditore, norma në rënie - por ende e lartë e EURIBOR-it, perspektiva e pasigurtë në tregjet globale dhe pozita e likuiditetit bankar ishin faktorët kryesor që ndikuan në shtrëngimin e lehtë të standardeve kreditore për këto segmente. Në anën tjetër, mbështetja nga FKGK kishte ndikim pozitiv në standardet kreditore për këtë segment. Për tremujorin e dytë të vitit 2024, pritjet e bankave për standardet kreditore nuk sugjerojnë për ndryshim kundrejt tremujorit të parë të vitit 2024 për ndërmarrjet e mëdha (shtrëngim marginal), kurse për NVM-të, standardet kreditore pritet të janë më të favorshme dhe të lehtësohen deri në një masë (tabela 1). Përkrahja nga FKGK, zbehja e faktorëve të brendshëm të rrezikut të perceptuar (kolaterali i kërkuar) dhe perspektiva e bankave vendore pritet të kenë efekt lehtësues në standardet kreditore. Në anën tjetër, ecuria në normat e financimit (EURIBOR), toleranca për rrezik nga bankat si dhe pozita e likuiditetit të bankave mund të kenë potencial shtrëngues, por në nivele margjinale.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKBK-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet në përgjithësi mbetën kryesisht të pandryshuara (brenda limitit $+0.05/-0.05$) për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Mirëpo, tek segmenti i NVM-ve u aplikua lehtësim i standardeve deri në një masë në kërkesën për kolateral, si dhe në madhësinë e kredisë së lejuar (lehtësim marginal). Tek ndërmarrjet e mëdha rezultoi të ketë pasur lehtësim marginal në madhësinë mesatare të kredisë, ngjashëm sikur tek NVM-të. Për të dy segmentet, rezultatet e agreguara sugjerojnë të ketë pasur shtrëngim marginal sa i përket maturitetit të kredive dhe në margjinën e normës së interesit në kreditë. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht deri në një masë nga ndryshimet potenciale në tolerancën e bankës ndaj rrezikut, cilësisë së portfolios kreditorë, si dhe nga norma e EURIBOR-it, por në nivel më të ulët. Në anën tjetër, kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan pozitivisht nga mbështetja nga FKGK dhe konkurrenca prej institucioneve jobankare (lehtësim deri në një masë). Në tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat priten të mbeten kryesisht të pandryshuara, me përjashtim të kërkesave për kolateral që priten të lehtësohen deri në një masë. Pozita e likuiditetit të bankave si dhe perspektiva e tregut vendor janë specifikuar si faktor që mund të ndikojnë negativisht kushtet dhe rregullat e kreditimit gjatë tremujorit të ardhshëm, faktorë që priten të neutralizohen nga konkurrenca dhe mbështetja prej FKGK-së.

Në tremujorin e parë të vitit 2024 u raportua për rritje deri në një masë të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, ngjashëm me dinamikën e tremujorit paraprak. Kërkesa për kredi rezultoi të ketë qenë më e lartë nga NVM-të, kundrejt kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha. Në përgjithësi, rritja e kërkesës për kredi, sipas deklarimeve të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse. Indeksi i gjeneruar për pritjet e bankave mbi kërkesën kreditorë gjatë tremujorit të ardhshëm sugjeron për rritje të lartë të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Këto pritje bankat i'a atribuon rritjes së pritjeve të kërkesës për investime fikse dhe financimit të inventarëve dhe kapitalit punues, në përputhje me ciklin e biznesit.

Aktiviteti kreditues ndaj ekonomive familjare ka vazhduar të zgjerohet me ritëm të lartë në TM1 2024, mbështetur si nga kahu i ofertës ashtu edhe kërkesës. Standardet kreditorë u lehtësuan deri në një masë si për kreditë për blerjen e shtëpive, ashtu edhe ato për ato konsumuese përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024. Në tremujorin e dytë të vitit 2024, standardet kreditorë të aplikuara nga bankat priten të jenë të ngjashme sikur në TM1 2024, pra të lehtësuara deri në një masë për të dy segmentet (tabela 1). Faktorët që përcaktuan zhvillimet në standardet kreditorë përgjatë TM1 2024 priten të mbetën të pandryshuar dhe të njëjtit të determinojnë dinamikën në TM2 2024.

Në përgjithësi, kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024. Rezultatet e gjeneruara reflektojnë lehtësim deri në një masë në margjinën e interesit në kredi dhe maturitetin e kredisë për kreditë për blerje të shtëpive, kurse për ato konsumuese në margjinën e interesit në kredi dhe madhësinë e kredisë mesatare. Bankat deklaruan se në lehtësim të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja ndikuan më shumë perspektiva e mirë e bankave lokale dhe konkurrenca nga bankat tjera, e më pak, kualiteti i kredisë, pozita e likuiditetit dhe besueshmëria e kredimarrësve. Për tremujorin e dytë të vitit 2024, bankat presin kushte dhe rregulla përgjithësisht të lehtësuara për kreditë e reja.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje të lartë në tremujorin e parë të vitit 2024, me kërkesën për kredi konsumuese që rezultoi të ketë qenë shumë më e lartë kundrejt asaj për blerje të shtëpive. Sipas bankave, nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe investimeve dhe rritja e besueshmërisë konsumatore (perspektiva më optimiste makroekonomike) ka ndikuar në rritjen e lartë të kërkesës për kreditë konsumuese. Ndërkohë, ishte perspektiva e tregut të patundshmërive që rezultoi të ketë kontribuar në rritjen e kërkesës për kreditë për blerje të patundshmërive. Edhe në tremujorin e dytë të vitit 2024, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, në një nivel të përafërt me atë aktual (tabela 1). Kërkesa për kredi në përgjithësi priten të nxitet kryesisht nga kërkesa për kreditë konsumuese, që kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë ndaj segmentit të ekonomive familjare, ndikuar nga besueshmëria e

konsumatorëve dhe nevoja për financim të shpenzimeve tjera familjare. Po ashtu, rritje të lartë të kërkesës pritet të ketë edhe për kreditë për blerje të shtëpive, mbështetur nga pritshmëritë për perspektivë të mirë në tregun e patundshmërive.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM1 2024	TM2 2024 (pritjet)	TM1 2024	TM2 2024 (pritjet)
Ndërmarrjet	➔	➔	➔	⬆
NVM	➔	➔	⬆	⬆
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	➔	⬆
Ekonomitë familjare	➔	➔	⬆	⬆
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	⬆	⬆
Kredi konsumuese	➔	➔	⬆	⬆

⬆	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
➔	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
➔	Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
➔	Shtyrje të standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
⬆	Shtyrje të standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Në tremujorin e parë të vitit 2024 bankat aplikuan qasje më lehtësuese në vlerësimin e aplikacioneve të reja, veçanërisht për kreditë konsumuese për ekonomitë familjare dhe për kreditë për ndërmarrjet e mëdha. Lehtësim në shqyrtim të aplikacioneve të reja kishte për kreditë me maturitet afatshkurtër, kurse për kreditë me maturitet afatgjatë, bankat ishin marxhinalisht më konservative për të dy segmentet (ndërmarrje dhe ekonomi familjare). Në tremujorin e dytë të vitit 2024, qasja e bankave në vlerësim të aplikacioneve të reja për kredi pritet të jetë më e lehtësuar, veçanërisht për ndërmarrjet e mëdha dhe kreditë konsumuese.

Qasja në financim nga bankat gjatë TM1 2024 rezultoi të jetë më e ulët krahasuar me rezultatet e tremujorit paraprak. Bankat deklaruan rritje më të ulët të financimit prej depozitave të ekonomive familjare në këtë tremujor krahasuar me tremujorin paraprak, kurse rënie të financimit prej depozitave të ndërmarrjeve dhe financimit nga tregjet e jashtme financiare. Sa i përket maturitetit, bankat deklaruan rritje deri në një masë të financimit afatshkurtër (deri në një vit), kurse rënie margjinale të financimit afatgjatë (mbi një vit). Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje më të lartë të financimit, kryesisht nga rritja e pritur e depozitave nga të dy segmentet, ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Gjatë tremujorit të ardhshëm pritet rritje të financimit me maturitet afatshkurtër, kurse ai afatgjatë nuk pritet të ketë ndryshime.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumëzës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, rezultati për standardet kreditore (politikat kreditore) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi nuk tregon dinamika të papritura apo të mëdha. Pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar (TM4 2023) për standardet kreditore të aplikuara ndaj ndërmarrjeve ishin në linjë me anketën e tanishme (TM1 2024), pra rezultojnë të jenë në nivele marginale në territorin negativ (shtrëngim) (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan




Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha dhe NVM-të me indeks negativ prej 0.01 për secilën kategori. Faktorët kryesor që ndikuan negativisht standardet kreditore, shtrëngim deri në një masë; ishin ndryshimet potenciale në rregullativën në Bashkimin Evropian, cilësia e portfolios kreditore, si dhe rritja e normës së EURIBOR me indekse negative prej 0.11, 0.11 dhe 0.06, respektivisht. Përderisa, faktori i vetëm që ndikoi deri në një masë në lehtësim të standardeve kreditore, duke i ofruar siguri sektorit bankar, ishin mbështetja nga FKGK-ja me indeks pozitiv 0.13. Faktorët tjerë që ndikuan në standardet kreditore kishin lëvizje marginale të ulët pozitive/negative dhe kryesisht kanë të bëjnë me perceptimin e rrezikut, koston e financimit dhe kufizimeve në bilancin e gjendjes, presionin nga konkurrenca dhe tolerancën ndaj rrezikut.

Standardet kreditore në përgjithësi pritet të kenë lëvizje marginale negative (shtrëngim) në tremujorin e ardhshëm, ngjashëm me rezultatet e gjeneruara të tremujorit aktual. Konkretisht, dhjetë nga gjithsej njëmbëdhjetë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan se nuk presin ndryshime në standardet kreditore për ndërmarrjet. Mbështetja nga FKGK pritet të kontribuoj deri në një masë pozitivisht standardet kreditore, përderisa ndryshimet potenciale në rregullativat në Bashkimin Evropian pritet të kontribuojnë negativisht deri në një masë. Faktorët tjerë pritet që të kenë lëvizje marginale pozitive/negative në standardet kreditore, siç janë perspektiva në tregun vendor, likuiditeti i sektorit bankar, cilësia e kredive me probleme, konkurrenca nga bankat dhe institucionet jo-bankare, perspektiva e bankave amë etj.

Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e parë të vitit 2024, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet e specifikuar për një kontratë të caktuar për kredi) mbetën kryesisht të pandryshuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (brenda limitit $+0.05/-0.05$) (grafiku 2). Konkretisht, lehtësimi deri në një masë u aplikua në kërkesën për kolateral për NVM-të me indeks pozitiv prej 0.07, kurse për ndërmarrjet e mëdha shtrëngim marginal prej 0.01. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e një banke me rëndësi sistemike (lehtësim tek NVM-të), kurse një banke të rëndësisë josistemike (tek ndërmarrjet e mëdha). Në anën tjetër, sa i përket madhësisë së kredisë mesatare, si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha do të ketë kushte të favorshme në nivele marginale, me indeks pozitiv prej 0.04, e shprehur nga një bankë me rëndësi josistemike. Pagesa tjetër përveç normës së interesit rezultoi të jetë e pandryshuar nga të gjitha bankat. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht deri në një masë nga ndryshimet potenciale në rregullativat në Bashkimin Evropian, cilësisë së portfolios kreditorë, tolerancës së rrezikut nga banka, dhe në nivel më të ulët nga norma e EURIBOR-it. Në anën tjetër, konkurrenca nga sektori jobankar dhe mbështetja nga FKGK-ja ndikuan pozitivisht deri në një masë në lehtësim të kushteve dhe rregullave të aplikuara.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Gjatë tremujorit të ardhshëm (TM2 2024), në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbeten të pandryshuara (brenda limiteve $+0.05/-0.05$). Si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, norma e aplikuar e interesit pritet të ketë ndryshime marginale negative, pasuar nga madhësia mesatare e kredisë. Kurse, lehtësimi deri në një masë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve prite të ketë në kërkesat për kolateral. Pozita e likuiditetit të bankave, rritja potencial e normës së EURIBOR dhe perspektiva e tregut vendor ndikuan negativisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat, e të cilat u neutralizuan nga konkurrenca prej institucioneve jobankare, mbështetjes nga FKGK-ja dhe uljes së rrezikut në kolateral të kërkuar.

Kërkesa për kredi


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet shënoi rritje deri në një masë, dinamike e ngjashme me tremujorin paraprak. Saktësisht, përgjigjet gjeneruan indeks pozitiv prej 0.15, e shprehur nga shtatë prej gjithsej njëmbëdhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre, dy banka me rëndësi sistemike dhe pesë banka tjera me rëndësi josistemike deklaruan rritje të kërkesës për kredi. Gjithashtu, kërkesa për kredi rezultoi të jetë e ngjashme me pritjet e bankave për TM1 2024 të shprehura në anketën e kaluar (TM4 2023) (grafiku 3).

Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga rritja e kërkesës për inventar dhe kapital punues me indeks pozitiv prej 0.37 si dhe investimeve

fikse me indeks pozitiv prej 0.18. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet kishte ndryshime marginale pozitive, pra përmirësim të aplikacioneve përgjatë TM1 2024, më konkretisht përmirësim në cilësinë e aplikacioneve të dorëzuara nga ndërmarrjet e mëdha.

Sipas anketës, gjatë TM1 2024 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u përmirësua, duke rezultuar me indeks negativ prej 0.22. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e katër bankave, ku prej tyre dy banka (dy me rëndësi sistemike) deklaruan rënie të raportit të kredive jo-performuese përdërisa tri banka tjera (një me rëndësi sistemike) deklaruan që niveli i kredive jo-performuese ishte i pandryshuar.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Për dallim nga tremujori aktual, ku bankat deklarua rritje të kërkesës për kredi deri në një masë, bankat presin rritje të theksuar të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm (TM2 2024). Konkretisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave (dy me rëndësi sistemike) të cilat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha. Këto pritje bankat ia atribuon kryesisht rritjes së kërkesës për financimin e inventarit dhe kapitalit punës si dhe investimeve fikse. Cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi edhe në tremujorin vijues pritet të ketë përmirësime marginale në përgjithësi, me cilësi më të mirë prej ndërmarrjeve të mëdha.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të ulet deri në një masë, pasi që rezultoi me indeks negativ 0.08. Tri banka, ku një prej tyre me rëndësi sistemike, presin rënie të raportit të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, përdërisa bankat tjera presin që ky raport të mbetet i pandryshuar.

Kreditë ndaj ekonomive familjare


Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 u lehtësuan deri në një masë. Lehtësim deri në një masë u aplikua për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.10, bazuar në përgjigjen e një banke me rëndësi sistemike, si dhe për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.06, bazuar në deklaratimet e një banke tjetër me rëndësi sistemike. Pritjet për tremujorin aktual, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar (TM4 2023), rezultuan të përafërta me vlerat aktuale, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive (grafiku 4). Perspektiva pozitive në treg prej bankave vendore ishte faktori me ndikimin më të madh në lehtësim të standardeve kreditore për ekonomitë familjare.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, bankat presin zhvillime të ngjashme sa i përket standardeve kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare: ndryshime deri në një masë pozitive (lehtësim) në

standardet kreditore; më e theksuar për kreditë për blerje të shtëpive (indeks pozitiv 0.10) dhe kreditë personale/konsumuese (indeks pozitiv 0.06). Faktorët që pritet të ndikojnë pozitivisht standardet kreditore janë perspektiva e bankave në tregun vendor, rritja e besueshmërisë së kredimarrësve, konkurrenca në nga bankat tjera, si dhe norma e EURIBOR-it, që nuk pritet të ndikohet në masë të madhe nga presionet inflacioniste, pasi që bankat qendrore kanë dhënë sinjal pozitiv nëse jo ulje, të mos i rrisin normat bazë të interesit.


Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuon



Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht kishin lëvizje pozitive në tremujorin e parë të vitit 2024. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë kushte më të mira për kreditë për blerje të shtëpive krahasuar me kushtet për kreditë konsumuese, por që dallimi nuk është i theksuar mes tyre. Saktësisht, bankat aplikuan norma marginale më të favorshme të interesit për kreditë për blerjen e shtëpive dhe ato konsumuese me indeks pozitiv prej 0.09, rezultat i ndikuar nga përgjigjet e dy bankave (njëra me rëndësi sistemike); përderisa dy banka tjera josistemike deklaruan shtrëngime marginale sa i përket normës së interesit. Bankat ofruan kushte më të mira për kreditë për blerje të shtëpive përmes zgjatjes së maturimit (lehtësim deri në një masë), kurse në sa i përket vlerës së kredisë lehtësim marginal pozitiv. Në anën tjetër, për kreditë konsumuese, kishte lehtësim deri në një masë në madhësinë mestarë të kredisë, kurse sa i përket maturitetit të kredisë, pagesave tjera përveç normës së interesi dhe kërkesës për kolateral, ato mbetën të pandryshuara. Faktori kryesor të cilët ndikuan pozitivisht në kushtet dhe rregullat ishin perspektiva e bankave në tregun vendor, konkurrenca bankare, besueshmëria e kredimarrësve si dhe cilësia e mirë kreditore (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Për tremujorin e dytë të vitit 2024, bankat në përgjithësi presin lehtësim deri në një masë të kushteve dhe rregullave për kredi për ekonomitë familjare. Bankat presin lehtësim deri në një masë sa i përket marginës së normës së internist në kredi, madhësisë së kredisë, maturiteti si dhe pagesave tjera përveç normës së interesit, si për kreditë konsumuese dhe ato për blerje të shtëpive (kushte lehtësisht

më të favorshme), përderisa kërkesa për kolateral për të dy kategoritë e kredive pritet të ketë lehtësime në nivele marginale.


Kërkesa për kredi

Rezultatet e anketës së TM1 2024 sugjerojnë se kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje dukshëm më të lartë krahasuar me rezultatet e gjeneruara në tremujorin paraprak (TM4 2023). Nëse e zbërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezultoni që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje të theksuar me indeks pozitiv prej 0.42, ndërsa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.27. Saktësisht, gjashtë banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike, raportuan për rritje të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa bankat tjera raportuan që kërkesa për kredi ishte e pandryshuar. Për kreditë konsumuese, tetë banka, prej tyre katër me rëndësi sistemike, deklaruan rritje të kërkesës për kredi, kurse tri bankat tjera raportuan që kërkesa kreditore ishte e pandryshuar. Nëse krahasojmë rezultatet e kërkesës aktuale për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i lartë (grafiku 6).

Nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe rritja e konfidencës së konsumatorëve kontribuan në rritje të kërkesës për kreditë konsumuese. Kurse, perspektiva pozitive në tregun e patundshmërive ka ndikuar në rritje të kërkesës për kreditë për blerje të shtëpive. Njëkohësisht, cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare shënoi rritje pozitive deri në një masë për kreditë konsumuese, me indeks pozitiv prej 0.08, përderisa për blerje të shtëpive shënoi rënie marginale, me indeks negativ prej 0.01.

Bankat deklaruan përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bazuar në indeksin pozitiv prej 0.13. Dinamikë e ndikuar nga përgjigjet e katër bankave, ku një prej tyre me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese, kurse një bankë tjetër e rëndësisë sistemike deklaroi rënie të raportit të kredive jo-performuese. Në anën tjetër, gjashtë bankat tjera, dy prej të cilave janë të rëndësisë sistemike deklaruan që nuk kishte ndryshime të nivelit të kredive jo-performuese.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Edhe në tremujorin e dytë të vitit 2024, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare pritet të jetë e lartë, duke tejkaluar nivelin e kërkesës së tremujorit aktual (TM1 2024). Konkretisht, bankat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese me indeks pozitiv prej 0.49 dhe për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.40. Pritjet për këtë dinamikë, u ndikuan nga përgjigjet e nëntë bankave (katër prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për kredi konsumuese. Po ashtu, nëntë bankave (katër prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive. Rezultatet e anketës sugjerojnë që kryesisht nevoja për të mbuluar shpenzimet e konsumit dhe besueshmëria e konsumatorëve pritet ta nxis këtë rritje të kërkesës për

kreditë konsumuese; dhe perspektiva e mirë e pritur në tregun e patundshmërive, kërkesën për kreditë për blerje të shtëpive. Bankat presin përmirësim deri në një masë në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi si për blerje të shtëpive dhe ato konsumuese, me cilësi më të mirë për kreditë me maturitet afatgjatë.


Për TM2 2024, cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare pritet të përkeqësohet në nivele marginale. Konkretisht, pritjet e bankave për raportin e kredive jo-performuese rezultuan në indeks pozitiv 0.01, deklaruar nga një bankë, e cila ka peshë të ulët në gjithsej kreditimin bankar, kurse bankat tjera deklaruan që gjatë TM2 2024, nivel i kredive me probleme nuk do të pësoj ndryshime.

Financimi

Bankat raportuan rritje deri në një masë të qasjes në financim gjatë tremujorit të parë të vitit 2024. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u bazua në përgjigjet e gjashtë bankave, prej tyre një bankë me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të financimit.

Bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve, financimi është karakterizuar me rritje deri në një masë në TM1 2024, megjithëse rritje më e ngadalësuar krahasuar me dy tremujorët paraprak, saktësisht indeks pozitiv 0.09 (indeks pozitiv 0.59 në TM4 2023 dhe 0.57 në TM3 2023). Depozitat e arkëtuara nga ekonomitë familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.20 (0.64 në TM4 2023), pothuajse trefish më i ulët krahasuar me TM4 2023. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e njëmbëdhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku prej tyre pesë banka deklaruan rritje deri në një masë të financimit, prej të cilave një me rëndësi sistemike. Për dallim nga tremujori paraprak, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve shënoi rënie deri në një masë; me indeks negativ 0.16 (indeks pozitiv 0.29 në TM4 2023 dhe 0.58 në TM3 2023), duke reflektuar përgjigjet e shtatë bankave pjesëmarrëse, ku prej tyre tri janë banka me rëndësi sistemike. Financimi nga bankat amë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare mbetën kryesisht të pandryshuara (grafiku 7). Sa i përket maturitetit të financimit, në këtë tremujor kishte rritje deri në një masë për maturitetet afatshkurtra, kurse për maturitetet afatgjata rënie marginale. Konkretisht, depozitat afatshkurtra gjeneruan indeks pozitiv prej 0.09, ndërsa ato afatgjata gjeneruan indeks negativ prej 0.02.

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje më të lartë të financimit kundrejt tremujorit aktual, me indeks pozitiv prej 0.20 (TM2 2024) nga 0.09 në TM1 2024. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.38, pasuar nga financimi nga depozitat e ndërmarrjeve me indeks pozitiv prej 0.23, deklaruar nga tetë banka të cilat presin rritje të këtyre burimeve të financimit. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të burojë nga maturitetet afatgjata dhe ato afatshkurtra, por me ndikim më të ulët nga këto të fundit. Konkretisht, pritet rritje e financimit afatgjatë me indeks pozitiv 0.26, përdërisa nga financim afatshkurter, me indeks pozitiv 0.16 (grafiku 7).

Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për tremujorin e parë të vitit 2024 është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet eminente në sektorin bankar, si dhe zbrërthimin e ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Pyetësi i anketës së realizuar në TM1 2024 ka për qëllim matjen e sentimentit të bankave rreth zhvillimeve kryesore dhe sfidave të sektorit financiar në gjashtëmujorin e ardhshëm dhe tërë vitin 2024. Efekti potencial i liberalizimit të vizave, politikat bankare rreth tregut të patundshmërive, si dhe ekspozimi/menaxhimi i likuiditetit ishin pyetjet shtesë që BQK ka parashtruar ndaj bankave. Në përgjigjet e tyre, në përgjithësi, bankat deklaruan se nuk presin ndonjë ndryshim të theksuar në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, pavarësisht shtimit të lëvizjeve të qytetarëve pas liberalizimit të vizave. Sa i përket sektorit të patundshmërisë, politikat e bankave në përgjithësi pritet të jenë të favorshme dhe do të jenë në një linjë me zhvillimet e përgjithshme makroekonomike në vend. Ndërsa, sa i përket likuiditetit, bankat në përgjithësi kanë deklaruar për qasje të kujdeshme për menaxhim të likuiditetit, dhe nuk presin vështirësi përgjatë gjashtë muajve në vijim.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, standardet kreditore kishin ndryshime marginale të papërfillshme në të gjithë sektorët ekonomik. Rezultat marginal negativ, që nënkupton shtrëngim të standardeve kreditore, kishte për sektorin e ndërtimitarisë me indeks negativ 0.02. Kurse, për sektorin e prodhimit, tregtisë, patundshmërisë dhe shërbimeve indeksi negativ ishte 0.01. Kushtet dhe rregullat u shtrënguan deri në një masë për sektorin e ndërtimitarisë, ndërsa shtrëngime marginale për sektorin e prodhimitarisë, shërbimeve, të patundshmërisë dhe atë të tregtisë. Në anën tjetër, kërkesa për kredi shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Sektori me kërkesën më të rritur për financim ishte ai i patundshmërisë, me indeks pozitiv 0.10, rritje e deklaruar nga tri banka, një prej të cilave me rëndësi sistemike. Njëkohësisht, sektori i dytë me kërkesë të rritur ishte sektori i tregtisë me indeks pozitiv prej 0.09, ngjashëm indeks të tillë kishte edhe ai i shërbimeve.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë tremujorit të ardhshëm bankat pritet të aplikojnë ndryshime të vogla në ofertën kreditore (shtrëngime marginale) për të gjithë sektorët ekonomik të përfshirë në anketë. Kushtet dhe rregullat pritet poashtu të kenë shtrëngime marginale. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritet të ketë lëvizje pozitive (rritje deri në një masë). Konkretisht, pritet rritje e kërkesës nga sektori i tregtisë prodhimitarisë dhe patundshmërisë (indeks pozitiv 0.13, 0.13 dhe 0.12, respektivisht).

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikën më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend. Kjo ndodhë duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikën më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikën e inflacionit. Nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKBK është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e çmimeve në vend. Kjo ndihmon në plotësimin e publikimeve tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e kaluar, pyetësi adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e dytë të vitit 2024 si dhe për vitin 2024 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për

identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit.

Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se ato shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore, shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Në bazë të anketës së kryer në prill të vitit 2024, bankat presin që niveli i inflacionit në tremujorin e dytë të vitit 2024 të jetë lehtësisht më i lartë krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa për gjithë vitin 2024, pritjet e bankave sugjerojnë nivelin e inflacionit pritjet të jetë 2.7 përqind. Pra, ka një ulje të pritjeve për inflacionin në krahasim me anketën e kaluar, kur bankat prisnin se niveli i inflacionit do të ishte 3.5 përqind në vitin 2024.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM1 2024	TM2 2024	2024
1	2.1%	2.5%	2.8%
2	2.3%	1.7%	2.1%
3	1.1%	0.1%	2.1%
4	2.7%	2.7%	2.7%
5	2.3%	3.1%	3.5%
6	2.1%	2.4%	2.8%
7	2.3%	3.3%	3.9%
8	2.2%	2.2%	1.2%
9	2.3%	2.4%	3.4%
10	2.2%	2.9%	3.3%
11	2.2%	2.0%	1.8%
Mesatarja	2.2%	2.3%	2.7%

Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.


Grafiku 8 ilustron shpërndarjet e raportuara të probabilitetit, duke treguar një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit. Kjo pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur disa faktorë kyç që kanë ndikuar dhe pritjet të ndikojnë në shkallën e inflacionit, duke përfshirë rënien e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, së bashku me ngadalësimin e rritjes së ekonomisë globale, duke marrë parasysh varësinë e madhe të ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave, etj.

Në anën tjetër, bankat kanë potencuar se rreziku ende mbetet i lartë për rritjen e inflacionit si rezultat i zhvillimeve gjeopolitike, sidomos luftës në Ukrainë, pasi Rusia dhe Ukraina janë furnizues të rëndësishëm të lëndëve të para. Gjithashtu, bankat presin që BQE të ulë normat e interesit, dhe kjo do të ndikonte në rritjen e inflacionit. Edhe presionet e brendshme për rritjen e pagave kontribuojnë në këtë rrezik.

Si përfundim, bankat presin që të ketë një ngadalësim të rritjes së inflacionit gjatë vitit 2024. Gjithashtu, edhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës deri në maj të vitit 2024 tregojnë për një ngadalësim të normës së inflacionit (norma mesatare 2.2 përqind). Megjithatë, pritjet për ngadalësim mund të ndikohen negativisht nga zhvillimet globale dhe pasiguria rreth tyre.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM2 2024 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org